

BULETINI 2025



KOMUNA E LIPJANIT



KORRIK

Komiteti për Komunitete ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 40-të me radhë



Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit, u mbajt mbledhja e 40-të e Komitetit për Komunitete (KK), e udhëhequr nga kryesuesi, z. Skender Bikliqi, ku u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës.

Gjatë takimit, Drejtori për Infrastrukturë, z. Sead Aliu, informoi anëtarët e KK-së lidhur me punimet që janë duke u zhvilluar në terren.

Në përfundim të mbledhjes, anëtarët e Komitetit shqyrtuan disa çështje dhe kërkesa të ndryshme që kanë pranuar nga komunitetet.

Kryetari Ahmeti viziton familjet bujqësore të prekura nga zjarri në fshatin Krojmir



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka vizituar nga afër tokat bujqësore të djegura në fshatin Krojmir, ku është takuar me bujqit dhe familjet e prekura nga zjarri që përfshiu rreth 15 hektarë tokë bujqësore në këtë zonë.

Me këtë rast, kryetari Ahmeti shprehu shqetësimin e tij për pasojat e zjarrit, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve për parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen.

“Jemi këtu për të dëgjuar nga afër shqetësimet e qytetarëve dhe për të ofruar përkrahjen institucionale që meritojnë. Dëmet në tokat bujqësore nuk janë vetëm humbje materiale, por edhe goditje për mundin e familjeve që jetën e kanë të lidhur ngushtë me tokën”, tha kryetari z. Imri Ahmeti.

Ai apeloj për kujdes maksimal, sidomos gjatë sezonit të verës, kur rreziku nga zjarret është më i madh, dhe rikujtoi se ndezja e zjarreve në ambiente të hapura është e ndaluar dhe e dënueshme me ligj.

Sipas banorëve, shkaktar i këtij zjarri dyshohet të jetë rrjeti i vjetër elektrik.

Komuna e Lipjanit do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të adresuar shqetësimin e banorëve pranë KEDS-it, si dhe do të formojë një komision profesional për vlerësimin e dëmeve.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim kapitenen e ekipit U16 të KV “Ulpiana”, Suela Luma, së cilës i ka ndarë një mirënjohje në shenjë vlerësimi për sukseset e arritura në sportin e volejbollit.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim kapitenen e ekipit U16 të KV “Ulpiana”, Suela Luma, së cilës i ka ndarë një mirënjohje në shenjë vlerësimi për sukseset e arritura në sportin e volejbollit.

Kryetari Ahmeti vlerësoi angazhimin, disiplinën dhe pasionin e Suelës për sportin, duke theksuar se ndihet krenar për sukseset e vajzave të reja të Komunës së Lipjanit, të cilat me talentin dhe përkushtimin e tyre po e përfaqësojnë me dinjitet komunën në arenën sportive.

Suela Luma ka qenë pjesëmarrëse aktive në gara komunale, republikane dhe në Kampionatin e Kosovës, duke shënuar rezultate të shkëlqyera. Ajo ka zënë vendin e parë në garat komunale, regjionale, si dhe në ato të organizuara në Qendrën Korrektuese.

Kryetari Ahmeti nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi me Lidhjen e Bizneseve të Kosovës



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi me Kryetarin e Lidhjes së Bizneseve të Kosovës, z. Besart Dreshaj, me qëllim të forcimit të bashkëpunimit institucional dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në komunën tonë.

Përmes kësaj marrëveshjeje, palët janë zotuar të bashkëpunojnë në promovimin e prodhimeve vendore, mbështetjen e sektorit privat, nxitjen e investimeve të huaja dhe zhvillimin e projekteve me karakter ekonomik, në të mirë të qytetarëve dhe bizneseve të Komunës së Lipjanit.

Në kuadër të këtij memorandumi, Komuna e Lipjanit do të ofrojë mbështetje për iniciativat që ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e klimës së të bërit biznes dhe në fuqizimin e sektorit privat.

Kjo është një tjetër dëshmi e përkushtimit institucional për krijimin e kushteve sa më të favorshme për zhvillim ekonomik dhe për të rritur bashkëpunimin me përfaqësuesit e sektorit privat.

Kryetari Ahmeti merr pjesë në hapjen e sallorit “Art Dekor Furniture” në Lipjan



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka marrë pjesë në hapjen solemne të showroom-it më të ri të mobilieeve, “Art Dekor Furniture”, një investim i realizuar nga vëllezërit Ismajli në qytetin e Lipjanit.

Me këtë rast, kryetari Ahmeti uroi vëllezërit Ismajli për hapjen e biznesit të ri, duke theksuar se çdo iniciativë e tillë përbën një lajm të mirë për Lipjanin, pasi bizneset private janë shtylla kryesore e zhvillimit ekonomik dhe e krijimit të vendeve të reja të punës.

Komuna e Lipjanit mbetet një partner i fuqishëm i bizneseve të reja dhe atyre ekzistuese, duke ofruar mbështetje dhe kushte të favorshme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim komandantin e ri të Stacionit Policor në Lipjan, kapitenin z. Brahim Shatrolli.



Me këtë rast, kryetari Ahmeti e uroi komandantin për detyrën e re dhe i dëshiroi suksese në përgjegjësitë që e presin. Ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve lokale dhe Policisë së Kosovës, në funksion të garantimit të një mjedisi sa më të sigurt për të gjithë qytetarët e komunës.

Takimi u mbajt me rastin e emërimit të z. Shatrolli në pozitën e komandantit të Stacionit Policor në Lipjan dhe shërbeu si një mundësi për të diskutuar mënyrat e forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitutional në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike.

Konferencë Ndërkomunale për Arsimin



Komuna e Lipjanit mori pjesë në Konferencën Ndërkomunale për Arsimin, e cila u mbajt në Prishtinë, me pjesëmarrjen e komunave të Lipjanit, Prishtinës, Obiliqit dhe Fushë Kosovës.

Me këtë rast, Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi përshëndeti këtë iniciativë dhe theksoi rëndësinë e platformave të tilla ndërkomunale për shkëmbimin e përvojave dhe avancimin e politikave arsimore.

Gjatë kësaj konference, Komuna e Lipjanit kontribuo me dy prezantime:

Bashkëpunimi me organizata joqeveritare dhe institucione të tjera për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

Investimet e vazhdueshme në ndërtimin e çerdheve në zonat rurale të komunës.

Kjo ngjarje e rëndësishme kishte për qëllim shkëmbimin e praktikave të mira, adresimin e sfidave dhe ndarjen e perspektivave të përbashkëta për zhvillimin e sistemit arsimor në nivel lokal.

Kryetari Ahmeti pret në takim nxënësin Adri Vila, fitues në Olimpiadën Ndërkombëtare STEM në Barcelonë



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim nxënësin e talentuar të SHFMU “Vëllezërit Frashëri”, Adri Vila, i cili ka përfaqësuar me sukses Kosovën në finalen e Olimpiadës Ndërkombëtare STEM, të mbajtur në Barcelonë, një nga garat më prestigjioze në botë për fëmijë dhe të rinj.

Me këtë rast, kryetari Ahmeti e uroi Adrin për suksesin e arritur, duke e cilësuar atë si një nga shembujt më frymëzues të rinisë së Lipjanit.

“Jam i lumtur dhe krenar për sukseset e njëpasnjëshme të nxënësve tanë. Adri është dëshmi e potencialit të jashtëzakonshëm që kanë të rinjtë e Lipjanit. Si institucion, jemi të përkushtuar ta mbështesim çdo hap të rrugëtimit të tyre drejt dijes dhe sukseseve të reja”, tha kryetari, z. Imri Ahmeti.

Në këtë garë ndërkombëtare, Adri Vila ka shkëlqyer duke u vlerësuar me Medaljen e Artë në Kodim , Çmimin “Best of the Best” , si dhe Medaljen e Argjendtë në Shkencë , duke dëshmuar punën, përkushtimin dhe talentin e tij të jashtëzakonshëm.

Në shenjë mirënjohjeje për përfaqësimin dinjitoz të Kosovës dhe Lipjanit, kryetari Ahmeti i dhuroi pllakatën e Komunës së Lipjanit.

Lipjani AERO FEST 2025 – Ngjarje unike ajrore dhe argëtuese



Me mbështetjen e Komunës së Lipjanit, po mbahen aktivitete në kuadër të “Lipjani AERO FEST 2025”, një ngjarje që sjell një kombinim të fluturimit sportiv, aventurës dhe argëtimit për të gjitha grupmoshat, duke ofruar përvoja të paharrueshme në natyrë dhe në qiell të hapur.

Vendi i mbajtjes: Vojnovc

Programi i festivalit përfshin:

- Kamping nën yjet e natës
- Muzikë live dhe performanca nga DJ të njohur
- Seanca relaksuese të jogës në natyrë
- Fluturime demonstrative me:
 - Aeroplanë Ultra Light
 - Delta Planë
 - Paramotorë
 - Paratrajk
- Trajtime dhe punëtori për sporte ajrore dhe aktivitete në natyrë

Komuna e Lipjanit, në bashkëpunim me Klubin Aeronautik “Shqiponjat e Kastriotit”, synon që përmes këtij festivali të promovojë sportet ajrore, turizmin e qëndrueshëm dhe stilin aktiv të jetesës.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, dhe drejtori i Organizatës "Qatar Charity", z. Esam Dabab, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e dy projekteve në Komunën e Lipjanit, si: furnizimin me inventar (banka, karrige dhe tabela) për shkollën "Zenel Hajdini" në Gadime, si dhe projektin e dytë shpërndarjen e granteve në sektorin e bujqësisë, konkretisht serra bujqësore dhe motokultivatorë me frezë dhe kosë, që synojnë fuqizimin ekonomik të familjeve në nevojë.




Me këtë rast, Kryetari i Komunës, z. Imri Ahmeti, ka falënderuar drejtorin e organizatës "Qatar Charity", z. Esam Dabab, për mbështetjen e vazhdueshme në realizimin e projekteve të përbashkëta që kanë synim përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

Nga ana tjetër, edhe Drejtori i Organizatës "Qatar Charity", z. Esam Dabab, ka falënderuar kryetarin e Komunës, z. Imri Ahmeti, për bashkëpunimin e singertë dhe korrekt të treguar deri më tani.

Ndryshe, Komuna e Lipjanit ka disa vite që ka bashkëpunuar ngushtë me organizatën "Qatar Charity", bashkëpunim ky i cili do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim autorin z. Mërgim Bekteshi, i cili me këtë rast i dhuroi librin e tij më të ri me titull “Trashëgimia sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit dhe të drejtës pozitive në Republikën e Kosovës”.



Kryetari Ahmeti e falënderoi autorin për dhuratën dhe vlerësoi kontributin e tij në fushën e shkrimit dhe trajtimin profesional të temave juridike e kulturore. Ky botim paraqet një qasje të veçantë, që ndërlidh trashëgiminë zakonore me të drejtën bashkëkohore, duke sjellë vlera të rëndësishme për studimet juridike dhe kulturore në vend.

Takim me të rinjtë në Lipjan – Fuqizim, mundësi dhe shpresë për të ardhmen



Në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, u mbajt takim i frytshëm me të rinjtë lipjanas, organizuar nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, në bashkëpunim me organizatat ASB Preda Plus dhe projektin Integra.

Qëllimi i këtij takimi ishte fuqizimi i të rinjve përmes informimit rreth mundësive në tregun e punës, aftësimit profesional dhe zhvillimit personal, jo vetëm në nivel lokal, por edhe më gjerë.

Me këtë rast, Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim, z. Valon Pacolli, theksoi se ky takim ishte një mundësi konkrete për të informuar dhe fuqizuar të rinjtë tanë rreth aftësimit profesional, mundësive në tregun e punës dhe ndërtimit të një të ardhmeje këtu, në vendin tonë. Kur të rinjtë fuqizohen, fuqizohet i gjithë vendi.

Përmes një dialogu të hapur, u diskutua për sfidat dhe nevojat reale me të cilat përballen të rinjtë sot, si dhe u ndanë ide konkrete për përmirësimin e kushteve dhe rritjen e përfshirjes së tyre në zhvillimin profesional.

Në fund të takimit, Komuna e Lipjanit u vlerësua me mirënjohje për kontributin dhe përkrahjen e vazhdueshme në projekte që sjellin zhvillim social dhe ekonomik për të rinjtë.

Ky takim bashkoi përfaqësues nga Zyra e Punësimit në Lipjan, Qendra për Aftësim Profesional në Prishtinë dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Filluan aktivitetet e festivalit “Mërgata Fest & Sports 2025”



Në ambientet e kompleksit sportiv Better Life, në një atmosferë plot energji, buzëqeshje dhe lojëra për fëmijët, filluan aktivitetet e festivalit “Mërgata Fest & Sports 2025”.

Fëmijët u bënë pjesë e aktiviteteve rekreative dhe lojërave të ndryshme argëtuese, të shoqëruara me surpriza të këndshme që sollën shumë gëzim. Festivali do të vazhdojë edhe në ditët në vijim, me një program të pasur dhe gjithëpërfshirës për të gjitha grupmoshat. Ju mirëpresim!

Me një atmosferë të jashtëzakonshme, Mërgata Fest & Sports 2025 shndërroi Lipjanin në epiqendrën e argëtimit, sportit dhe pasionit për veturat klasike!



Me një atmosferë të jashtëzakonshme, Mërgata Fest & Sports 2025 shndërroi Lipjanin në epiqendrën e argëtimit, sportit dhe pasionit për veturat klasike!

Aktivitetet sportive bashkuan garues të të gjitha moshave në Teqball, Ping Pong, Shah, Streetball, Futboll, Tenis dhe Volejboll, të zhvilluara në ambientet e kompleksit sportiv "Better Life", palestrës së re moderne dhe në sheshin "Adem Jashari", duke krijuar një atmosferë dhe emocione të paharruara!

Retro Ride Show – Old Timer mbushi sheshin "Adem Jashari" me zhurmën karakteristike të motorëve, ngjyrat e së kaluarës dhe një ndjenjë të veçantë nostalgjie. Një ekspozitë unike për të gjithë dashamirët e veturave klasike dhe stilit vintage!

Festivali vazhdon!

Nga data 29 deri më 31 korrik, qytetarët dhe mërgata jonë janë të ftuar të marrin pjesë në koncertet madhështore që do të mbahen në sheshin "Adem Jashari"!

Ju mirëpresim!

Komiteti për Komunitete ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 41-të me radhë



Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit, u mbajt mbledhja e 41-të e Komitetit për Komunitete (KK), e udhëhequr nga kryesuesi, z. Skender Bikliqi, ku u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës.

Gjatë takimit, zyrtari kryesor financiar paraqiti informacione lidhur me buxhetin për vitet 2026–2028 të Komunës së Lipjanit, veçanërisht për projektet në zonat ku jetojnë komunitete jo-shumicë.

Në përfundim të mbledhjes, anëtarët e Komitetit shqyrtuan disa çështje dhe kërkesa të ndryshme të pranuar nga komunitetet.

Finalja e edicionit të pestë të festivalit “Mërgata Fest & Sports”



Pas pesë ditësh me aktivitete sportive dhe argëtuese, mbrëmë u përmbyll me sukses edicioni i pestë i këtij festivali, i cili tashmë është shndërruar në një traditë që bashkon qytetarët dhe mërgimtarët rreth sportit, argëtimit dhe shoqërimit.

Në natën finale u zhvilluan garat përfundimtare në të gjitha disiplinat sportive, ndërsa kampionëve iu ndanë medaljet, një vlerësim i merituar për angazhimin, përkushtimin dhe shpirtin e tyre sportiv.

Disiplinat finale ishin: Futboll, Pingpong, Teqball, Shah, Tennis, Flippera, Krah për krah (arm wrestling), Peshëngritje, Volejboll dhe Streetball.

Lipjani – qyteti i sportit dhe sportistëve!

Nata e parë e koncertit festiv “Mërgata Fest & Sports 2025”



Mbrëmë në sheshin “Adem Jashari” në Lipjan, u mbajt nata e parë e festivalit “Mërgata Fest & Sports 2025”, me një koncert madhështor dhe pjesëmarrje të jashtëzakonshme të qytetarëve dhe mërgimtarëve tanë.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, përshëndeti të pranishmit nga skena, duke theksuar rëndësinë e mërgatës për qytetin tonë. Ai u shpreh se sa herë që mërgimtarët kthehen në vendlindje, Lipjani duket më i bukur dhe më i buzëqeshur.

Performancat e artistëve të njohur shqiptarë i dhanë qytetit një atmosferë fantastike dhe një energji të veçantë.

Festivali vazhdon sonte me këngëtarë të mirënjohur – ejani të festojmë së bashku!

Nata e dytë e “Mërgata Fest & Sports 2025” një mbrëmje e jashtëzakonshme.



Festivali vazhdoi me një natë të mbushur me energji, ritëm dhe emocion, duke sjellë një atmosferë festive që e gjallëroi qytetin dhe mbledhi qindra të rinj e qytetarë në sheshin “Adem Jashari”.

Artistët e mirënjohur sollën performanca të mrekullueshme, ndërsa publiku lipjanas e ktheu mbrëmjen në një festë të paharruar.

Mbrëmja finale është sonte. Ju mirëpresim për të përjetuar edhe një natë tjetër plot muzikë dhe atmosferë fantastike!



Komuna e Lipjanit – Zyra për informim



<https://lipjan.rks-gov.net/>



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



0 800 14 000 / 038 200 41 508